



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 22.04.2025
Numër Protokolli: 2674/2025

A.nr.160/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Çlirim Zeka në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.160/2025 të datës 22.01.2025 të parashtruar nga ankuesi N.I, kundër organit të punësimit Agjencia Kosovare e Privatizimit, në çështjen juridike “*Kompensim Material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.160/2025 e datës 22.01.2025 e parashtruar nga ankuesi N.I.

II. Shfuqizohet Vendimi DE47/2025 i datës 15.01.2025 i Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

III. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, të ndërmarr të gjitha veprimet që ankuesit t’i bëjë kompensimin e shumës së shtesës tranzitore në vlerë e shumës së zvogëluar në mënyrë retroaktive nga muaji prill 2023, deri në pagën defitnitive apo zbatimin e këtij vendimi.

IV. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën III.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil N.I (*tutje referuar vetëm* ankuesi), më datë 22.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 428/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor kundër vendimit me numër DE47/2025 të datës 15.01.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, kërkon që të obligohet Agjencia Kosovare e Privatizimit për kompensimin në vlerën prej 250 euro në emër të zbritjes së pagës bazë e cila është zbritur si rezultat i aplikimit të shtesës për kushte tregu në po të njëjtën vlerë dhe kjo pagesë duhet të bëhet në mënyrë retroaktive nga Prilli 2023 dhe deri në pagesën definitive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.01.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kosovare e Privatizimit, ndërsa Këshilli më datë 07.02.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë vendimin me numër VK/2025 me datë 04.03.2025 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 428/2025 të datës 22.01.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me numër DE47/2025 i datës 15.01.2025; Vendim i KPMSHCK me numër protokolli 6838/2024 i datës 17.12.2024; Ankesë e N.I. e datës 17.10.2024; Pasqyra mujore e pagës për muajin Prill 2023; Vendim i Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve me numër Nr.18 i datës 31.03.2023; E-mail nga F.M. për N.I. i datës 24.09.2024; E-mail nga K.L. për F.M. i datës 23.09.2024; E-mail nga F.M. për K.L. i datës 23.09.2024; E-mail nga N.I. për F.M. i datës 18.09.2024; Akt Emërim i N.I. i datës 26.10.2023; Përshkrimi i punës për pozitën Zyrtar i Lart për Shitje i datës 14.12.2023; E-mail nga K.L. për N.I. i datës 04.07.2023; E-mail nga K.L. për A.T. etj. i datës 31.05.2023; E-mail nga K.L. për A.T. etj. i datës 10.05.2023; Letërnjoftim i N.I.; E-mail nga N.I. për ankesa.kpmschck@rks-gov.net i datës 22.01.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 31.01.2025; Përgjigje në ankesë i datës 07.02.2025; Kërkesë për pagesë retroaktive i datës 10.05.2023; Lista e pagave e muajit Janar deri Shtator 2024; Lista e pagave Janar deri Dhjetor 2023; Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese me numër Nr.KO203/19; Vendim i KPMSHCK për vazhdimin e afatit me numër protokolli 1434/2025 i datës 04.03.2025; Pliko me numër R6842484 i datës 20.12.2024; Fletëkthesë e datës 26.12.2024; Njoftim për zbatim të vendimit nga AKP me numër protokolli 344 i datës 16.01.2025; E-mail nga F.M. për HR i datës 24.10.2024; Përgjigje në ankesë i datës 31.10.2024; E-mail nga F.M. për HR i datës 31.01.2025; E-mail nga F.M. për C.Z. i datës 18.03.2025; E-mail nga C.Z. për F.M. i datës 17.03.2025; E-mail nga M.Q. për Xh.Z. i datës 26.02.2024; E-mail nga Xh.Z. për M.Q. etj. i datës 20.02.2024; E-mail nga Xh.Z. për M.Q. etj. i datës 12.02.2024; E-mail nga M.Q. për Xh.Z. i datës 06.02.2024; E-mail nga M.Q. për Xh.Z. i datës 01.02.2024; E-mail nga Xh.Z. për M.Q. i datës 01.02.2024; E-mail nga M.Q. për Xh.Z. i datës 19.01.2024; E-mail nga Q.B. për Xh.Z. i datës 17.01.2024; E-mail nga Xh.Z. për Q.B. i datës 12.01.2024;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Nga shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se sipas Akt Emërimit të datës 26.10.2023 rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën “Zyrtar i Lartë për Shitje” në Departamentin e Realizimit të Aseteve dhe shpërndarjeve Divizioni i marketingut dhe tenderit publik në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Kolegji i Këshillit fillimisht ka konstatuar se ankuesi kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 17.10.2024. Ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka nxjerr vendimin me numër protokolli 6838/2024 me datë 17.12.2024 përmes të cilit ka detyruar Udhëheqësin e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës së datës 18.09.2024 që ndërlihet me kërkesën e ankuesit.

Ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit ka nxjerr vendimin me numër DE47/2025 me datë 15.01.2025 ku theksohet se i takon shtesa për kushte të tregut të punës në vlerë prej 250 Euro në muaj për periudhën Prill 2023 deri në pagesën definitive.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor kundër vendimit me numër DE47/2025 të datës 15.01.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, kërkon që të obligohet Agjencia Kosovare e Privatizimit për kompensimin në vlerën prej 250 euro në emër të zbritjes së pagës bazë e cila është zbritur si rezultat i aplikimit të shtesës për kushte tregu në po të njëjtën vlerë dhe kjo pagesë duhet të bëhet në mënyrë retroaktive nga Prilli 2023 dhe deri në pagesën definitive.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, në fuqi nga data 05.02.2023, me theks të veçantë:

- **Nenit 1:** 1. Qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë.

- **Nenit 2** paragrafi 1 dhe 3: 1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, përjashtimisht Agjencisë Kosovare për Inteligjencë. 3. Për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, ky ligj zbatohet për atë që nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë”.

- **Nenit 6**, paragrafi 1: 1. Paga bazë është pjesa fikse e pagës që përfitohet për punën e kryer me orar të plotë apo punën me orar të pjesshëm që konsiderohet si punë me orar të plotë, në një funksion apo pozitë të caktuar që përcaktohet nga grupi dhe klasa e pagës së cilës i përket funksioni apo pozita, ashtu siç është përcaktuar në shtojcat e këtij ligji.

- **Nenit 3** paragrafi 1 nën paragrafi 1.6, 1.8, 1.9, 1.10, ku përcaktohet: 1.6. klasa e pagës - nënkupton nivelin e pozicionimit në hierarkinë e përgjithshme të funksioneve në shkallën e pagës e që i korrespondon koeficienti i caktuar dhe që përbëhet nga një grup funksionesh, pozitash apo gradash me nivel të njëjtë apo pothuajse të njëjtë kompleksiteti dhe që përfitojnë të njëjtën pagë bazë; 1.8. kompensim - nënkupton pagesën në formën e mbulimit të shpenzimeve të kryera apo që do të kryhen nga e/i punësuarat/i, për udhëtime, qëndrim apo përfaqësim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, apo kompensimi për punë gjatë

natës, jashtë orarit të punës dhe kompensimi për kujdestari; 1.9. paga bazë – nënkupton elementin kryesor fiks të kundërvlerës monetare mujore që i përgjigjet nivelit të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë, në përputhje me shtojcat e këtij ligji; 1.10. paga mujore apo paga – nënkupton kundërvlerën monetare që përfshin pagën bazë, shtesat dhe të drejtat e tjera të pagës, që për qëllimin e këtij ligji trajtohet si pagë primare.

- Nenit 41: 1.Nëse një zyrtar/e publik/e apo funksionar/e publik/e, para hyrjes në fuqi të këtij ligji përfitonte pagë që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ajo/ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë.2. Të punësuarat/it, zyrtarja/i publik/e apo funksionarja/i publik/e, në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, do të përfitojë pagën e re në: 2.1. 100% të shtesës tranzitore të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të parë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji; 2.2. 50 % të shtesës tranzitore të posaçme, sipas paragrafit 1, gjatë vitit të dytë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. 3. Përrjashtimisht nga paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni, anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm nuk gëzojnë të drejtën e shtesës tranzitore. 4. Çdo person që punësohet pas miratimit të këtij ligji përfiton pagën sipas këtij ligji dhe nuk gëzon të drejtën e shtesës tranzitore.

Po ashtu, Kolegji për vendosje të drejtë dhe meritore mori parasysh edhe përcaktimet e Gjykatës Kushtetuese sipas Aktgjykimit për rastin nr.KO79/23, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, e për rrjedhojë Gjykata Kushtetuese me Aktgjykimin në rastin Nr.KO79/23, ka sqaruar: Pika 323.Në kontekst të përcaktimit të “ndërrhyrjes/kufizimit” të së drejtës në gëzimin paqësor të pronës të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve publikë përmes Ligjit të kontestuar, sipas në kontekst të sqarimeve të mësipërme, Gjykata thekson që nuk është kontestuese që një pjesë të konsiderueshme të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që bien në fushëveprimin e Ligjit të kontestuar, iu është zvogëluar paga, përderisa një pjesë tjetër iu është ngritur paga. Për më tepër, Gjykata thekson që neni 45 i Ligjit të kontestuar shfuqizon dispozitat e të gjitha ligjeve të veçanta dhe të cilat kanë përcaktuar nivele/raporte të pagave dhe/ose të drejta të caktuara të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve të shtetit, përfshirë të drejtën e gjyqtarëve dhe prokurorëve për ruajtje të pagës gjatë mandatit përgjatë të cilit janë zgjedhur. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata thekson që nuk është kontestuese që Ligji i kontestuar, ka “ndërrhyrë/kufizuar” të drejtat e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve të shtetit të përcaktuara me ligjet e Republikës së Kosovës dhe të cilat shfuqizohen me hyrjen në fuqi të Ligjit të kontestuar. Pika 380. Gjykata ka konstatuar se paragrafi 6 i nenit 6 (Paga bazë) dhe paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 (Shtesa tranzitore) të Ligjit të kontestuar janë në kundërshtim me Kushtetutën, përkatësisht me të drejtën në gëzimin paqësor të pronës dhe barazinë para ligjit. Kjo, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, ndër të tjera, sepse (i) zbritja joproporcionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës është në kundërshtim të plotë me parimet kushtetuese, ligjore, parimet relevante ndërkombëtare dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe përtej cenimit të të drejtave respektive individuale, rezulton edhe në cenim të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe vlerave të Republikës së Kosovës; (ii) zbritja e nivelit të pagës dhe përjashtimi nga të drejtat e periudhës tranzitore të kategorisë së shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës është plotësisht joproporcionale dhe përtej cenimit të së drejtës në gëzim paqësor të pronës, cenon edhe parimin e barazisë para ligjit; (iii) mekanizmat e zgjedhur nga Qeveria dhe Kuvendi për zbritjen e nivelit të pagave të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që hyjnë në fushëveprimin e Ligjit të kontestuar, nuk janë proporcionale me qëllimin e ndjekur, dhe për pasojë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në nenin 55 të Kushtetutës; (iv) përcaktimi i dallimit në mes funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që janë punësuar para ose pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar, në kontekst të të drejtave të përcaktuara përmes periudhës tranzitore, afekton të drejtat për barazi para ligjit sepse nuk është proporcional me qëllimin e ndjekur; ndërsa (v) përgjysmimi i shtesës për përvojën e punës për të gjithë kategorinë e funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, kufizon të drejtat dhe liritë themelore të tyre, pa asnjë qëllim legjitim në kundërshtim

me përcaktimet e nenit 55 të Kushtetutës. 383. Ndërsa, në balancimin në mes të drejtave dhe lirive themelore dhe parimit të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë, Gjykata, përmes këtij Aktgjykimi do të shpallë të pavlefshme dhe do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. Shfuqizimi i paragrafëve që ndërlidhen me periudhën tranzitore, bazuar në paragrafin 1 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar, ka pasojën e (i) mbajtjes së nivelit ekzistues të pagave në sektorin publik, përkatësisht pamundësinë e zbritjes së pagave deri sa paga e re të bëhet e barasvlershme me pagën aktuale; (ii) kthimin e pagës të paktën në nivelin para hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar për kategorinë e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të cilët nuk kanë përfituar nga shtesa tranzitore prej njëqind përqind (100%) përgjatë vitit 2023, për dallim nga të gjitha kategoritë tjera; dhe (iii) nivelizimin e pagave të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që janë punësuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar sipas përcaktimeve të pikës 1.4 të nenit 4 (Parimet e sistemit të pagave) të Ligjit të kontestuar.

Në fakt, Gjykata Kushtetuese përmes konstatimeve të dhëna në pjesën **IV. Efektet e Aktgjykimit**, ka sqaruar me pikën 376. Konstatimet e Gjykatës sipas sqarimeve të dhëna në këtë Aktgjykim, ndikojnë në efektet e këtij Ligji në dy mënyra. **E para** ndërlidhet me konstatimet e Gjykatës lidhur me sistemin e pagave dhe shpërblimeve dhe procedurave përkatëse për aq sa afektojnë pavarësinë funksionale, organizative dhe buxhetore të institucioneve të pavarura kushtetuese; **ndërsa e dyta** ndërlidhet me konstatimet e Gjykatës lidhur me zbritjen e nivelit të pagës së funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që hyjnë në fushëveprimin e Ligjit të kontestuar sipas përcaktimeve të Shtojcave të Ligjit të kontestuar, sipas sqarimeve në vijim:..”.

Për më tepër bazuar në sqarimet e dhëna përmes pjesës **IV. Efektet e Aktgjykimit**, më konkret nga pika 373 e deri tek pika 388, arrihet në përfundimin se paragrafi 2 i nenit 45 të Ligjit të Pagave në Sektorin Publik, është shpallur i pavlefshëm vetëm në raport me Institucionet e pavarura kushtetuese dhe Sistemit të drejtësisë, ndërsa paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të Pagave në Sektorin Publik, shpallen të pavlefshëm në raport me të gjitha institucionet shtetërore. Në ndërlidhje me këtë të fundit, Kolegji rithekson përcaktimet si në pikën 385, të aktgjykimit ku shprehimisht thuhet: “385. Bazuar në pretendimet dhe argumentet e parashtruara para saj, Gjykata nuk ka trajtuar Shtojcat që janë pjesë përbërëse e nenit 44 të Ligjit të kontestuar. Përkundër faktit që (i) bazuar në vet Ligjin të kontestuar, ulja e pagës mund të bëhet vetëm si rezultat i një tronditje makroekonomike e cila rezulton në zvogëlimin e të ardhurave dhe/ose një fatkeqësie natyrore sipas kuptimit të nenit 131 të Kushtetutës, përkatësisht shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në Republikën e Kosovës; dhe (ii) emëruesit të përbashkët të praktikës gjyqësore të Gjykatave tjera Kushtetuese, GJEDNJ-së dhe GJDBE-së, që ulja e pagës, në parim, mund të bëhet vetëm në rrethana të krizave ekonomike dhe/ose financiare, Gjykata ka vlerësuar qëllimin e Ligjit të kontestuar për të krijuar “një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik” si qëllim legjitim. Për pasojë, ajo nuk ka shpallur në kundërshtim me Kushtetutën nenin 44 të Ligjit të kontestuar përkitazi me Shtojcat në lidhje me paragrafin 1 të nenit 45 të Ligjit të kontestuar që përfshinë shfuqizimin e një numri të dispozitave të ligjeve të veçanta dhe të cilat rregullojnë pagën e një numri institucioneve në Republikën e Kosovës. **Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, “një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik” arrihet përmes paragrafit 1 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar dhe sipas të cilit, nëse një zyrtar/e publik/e apo funksionar/e publik/e, para hyrjes në fuqi të këtij ligji përfitonte pagë që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ajo/ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë.**

Nisur nga fakti se e drejta e pagës, përbën një nga të drejtat më themelore nga marrëdhënia e punës, Gjykata Kushtetuese bazuar në praktikën e saj të mëhershme, sërish me Aktgjykimin për rastin Nr.KO79/23, ka ritheksuar se e drejta në pagë të fituar është e drejtë e pronës dhe ka të gjitha atributet e

kësaj të drejte të garantuar më kushtetutë, rrjedhimisht si e drejtë e pa tjetërsueshme, duke sqaruar përmes pikës 383 të aktgjykimit se: *Ndërsa, në balancimin në mes të drejtave dhe lirive themelore dhe parimit të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë, Gjykata, përmes këtij Aktgjykimi do të shpallë të pavlefshme dhe do të shfuqizojë paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar. Shfuqizimi i paragrafëve që ndërlidhen me periudhën tranzitore, bazuar në paragrafin 1 të nenit 41 të Ligjit të kontestuar, ka pasojën e (i) mbajtjes së nivelit ekzistues të pagave në sektorin publik, përkatësisht pamundësinë e zbritjes së pagave deri sa paga e re të 110 bëhet e barasvlershme me pagën aktuale; (ii) kthimin e pagës të paktën në nivelin para hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar për kategorinë e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës dhe të cilët nuk kanë përfituar nga shtesa tranzitore prej njëqind përqind (100%) përgjatë vitit 2023, për dallim nga të gjitha kategoritë tjera; dhe (iii) nivelizimin e pagave të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve që janë punësuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar sipas përcaktimeve të pikës 1.4 të nenit 4 (Parimet e sistemit të pagave) të Ligjit të kontestuar”.*

Rrjedhimisht, referuar përcaktimit si më lartë dhe duke shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit, në bazë të provave materiale të lëndës gjegjësisht sipas listës së pagave të muajit janar 2023, para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin, ka realizuar pagë buri prej 1,294.26 Euro, ndërsa pas hyrjes në fuqi të këtij ligji sipas listës së pagave të muajit shkuar dhe mars i njëjti ka marr pagë të njëjtë bruto duke realizuar edhe shtesën tranzitore prej 670.89 Euro, ndërsa pasi që ankuesi ka përfituar shtesën për kushtet e tregut për Skemat e Profesionistëve të Rinjë Youn Cell Shkencës, si rezultat i studimeve të bashkëfinancaura nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, dhe këtë shtesë ankuesi e ka realizuar nga muaji prill 2023 ku sipas listës së pagave të këtij muaji i njëjti ka realizuar pagë bruto prej 1,294.26 Euro, ku kanë përfshirë shtesë prej 250 Euro në emër të shtesës së kushteve të tregut dhe në vlerën prej 419.38 Euro në emër të shtesës tranzitore dhe njëjtë ka marr deri në dhjetor 2023, ndërsa nga janari 2024 deri në shtator ka marr pagën bruto prej 1,294.26 Euro ku janë përfshirë shtesa për kushte të tregut prej 250 Euro dhe shtesa tranzitore 388.04 Euro.

Kolegji i Këshillit, në bazë të provave të lëndës të administruara, vlerëson se ankuesit nga koha kur ka përfituar shtesën për kushtet e tregut për Skemat e Profesionistëve të Rinjë Youn Cell Shkencës, si i studimeve të bashkëfinancaura nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria e Republikës së Kosovës prej 250 Euro, të njëjtit nga muaji prill i është zbritur shtresa tranzitore në vlerën e kësaj shume, e që kjo sipas Kolegji të Këshillit, nuk ka qenë as ligjore në kundërshtim të plotë me Aktgjykimin për rastin nr.KO79/23 të Gjykatës Kushtetuese, sepse siç është thënë në këtë aktgjykim që elaboruam më sipër, nëse një zyrtar/e publik/e apo funksionar/e publik/e, para hyrjes në fuqi të këtij ligji përfitonte pagë që është më e madhe se paga e plotë e parashikuar me këtë ligj, ajo/ai do të përfitojë pagën e re sipas dispozitave të këtij ligji dhe shtesën tranzitore të barabartë me diferencën ndërmjet pagës aktuale dhe pagës së re bazë. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se nuk ka bazë juridike që shtesa tranzitore e ankuesit të zvogëlohet si rezultat i përfitimit të një shtese tjetër, ngase shtesa tranzitore është e garantuar meqë ankueis duhet të merr pagë më të vogël se paga që ka pasur para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, ndërsa shtesën për kushtet e tregut ankuesi e ka realizuar si një shtesë e parashikuar me nenin 22 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe nenin 24 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë dhe dispozitave të Rregullores (MFPT) Nr. 02/2023 për Shtesën për Kushte të Tregut të Punës dhe si rezultat i kësaj ankuesi duhet të përfitojë plagën e plotë së bashku me shtesën tranzitore e barabartë me pagën që ka pasur para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, ndërsa shtesat dhe kompensimet e tjera të parashikuara me këtë ligj janë pjesë përbërëse e pagës, ngase paga bazë nënkupton elementin kryesor fiks të kundërvlerës monetare mujore që i përgjigjet nivelit të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë, në përputhje me shtojcat e këtij ligji, ndërsa paga mujore apo paga nënkupton

kundërvlerën monetare që përfshin pagën bazë, shtesat dhe të drejtat e tjera të pagës, që për qëllimin e këtij ligji trajtohet si pagë primare.

Andaj Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar me ankesë, gjegjësisht Vendimit DE47/2025 i datës 15.01.2025 i Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, duke konstatuar se në rastin konkret ankuesi është dashur t'i njihet vetëm e drejta në kompensim të shtesës tranzitore të zvogëluar, në këtë rast ky vendim është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Përkitazi me konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit, vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit janë plotësisht të bazuara, ashtu që organi përkatës i punësimit respektivisht Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, është i obliguar të ndërmarr të gjitha veprimet që ankuesit t'i bëjë kompensimin e shumës së shtesës tranzitore në vlerë e shumës së zvogëluar në mënyrë retroaktive nga muaji prill 2023, deri në pagën defitnitive apo zbatimin e këtij vendimi.

Bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.160/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit N.I;
- Organit të punësimit: (Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit) dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.